

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE

NR. 2224 / 5



VENDIM
IGJYQTARES SE VETME

Sot me date 27.07.2018, une gjyqtare **Ariana Gunbardhi (Caco)** e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit Naim Alija, me cilesine e Drejtorit Ekzekutiv te **Agjensia e Administrimit Kolektiv te te Drejtave te Artisteve Interpretues dhe Ekzekutiv (AKDIE)**, i cili kerkon depozitimim e vendimeve te Mbledhjeve se Asamblese se Pergjithshme te Artisteve te saj ;

KONSTATOVA :

Agjensia e Administrimit Kolektiv te te Drejtave te Artisteve Interpretues dhe Ekzekutiv (AKDIE) eshte e regjistruar si person juridik prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me vendim nr.2224.

Ne Mbledhjen e Pergjithshme te Asamblese se Artisteve sipas vendimit nr.2, date 27.07.2017 eshte vendosur :

Miratimin e veprimtarise se agjencise "AKDIE" per periudhen janar-korrik 2017 sipas rregullave statutore te Statutit te miratuar me vendim nr.2224/4, date 27.03.2012 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane ne fuqi deri me miratimin e srtatutit te ri te Agjencise AKDIE.

Miratimin e Statutit te ri te Agjensise se Administrimit Kolektiv te te Drejtave te Artisteve Interpretues dhe Ekzekutues "AKDIE" ne perputhje me ligjin nr.35/2016 "Per te drejtat e Autorit dhe te Drejtat e tjera te lidhura me to".

Per kete eshte nxjerre urdheri nr.409, date 22.06.2017 nga Ministria e Kultures dhe i ka miratuar keto ndryshime statutore te propozuara nga ana e Agjencise AKDIE.

Gjithashtu me vendimin nr.3, date 18.12.2017 eshte vendosur miratimi i veprimtarise administrative te agjencise AKDIE per vitin 2017 , Miratimi i anetareve te Keshillit te Auditit dhe pranimi i anetareve te rinj.

- Ngarkohet Drejtori Ekzekutiv z, Naim Alija per te kryer te gjitha veprimet e nevojshme per te pasqyruar ndryshimet e mesiperme te statutit dhe organeve drejtuese te shoqates ne skeden e regjistrimit te saj ne Regjistrin e Organizatave Jofitimpruese prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kerkuesi kerkon depozitimim e ketyre akteve prane Agjensise se Administrimit Kolektiv te te Drejtave te Artisteve Interpretues dhe Ekzekutues "AKDIE", qe ndodhet ne Regjistrin e Organizatave Jofitimpruese ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane ne baze te ligjit 8789, dt.07.05.2001 "Per regjistrimin e Organizatave Jofitimpruese"

Kerkesa e tij eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.



PER KETO ARSYE :

Ne baze te ligjit 07.05.2001 dhe ligjit 8788, dt.7.05.2001 "Per organizatat humane dhe jofitimpruese" dhe ligjit 8789, date 07.05.2001,

VENDOSA

Pranimin e kerkeses.

Depozitim ne regjistrin e OJQ-ve te vendimit nr.2, date 27.07.2017, te Asamblese se Pergjithshme te Agjensise se Administrimit Kolektiv te te Drejtave te Artisteve Interpretues dhe Ekzekutues "AKDIE".


- Statutin e ri te Agjensise se Administrimit Kolektiv te te Drejtave te Artisteve Interpretues dhe Ekzekutues "AKDIE" ne perputhje me ligjin nr.35/2016 "Per te drejtat e Autorit dhe te Drejtat e tjera te lidhura me to" se bashku me urdherin nr.409, date 22.06.2017 nga Ministria e Kultures dhe i ka miratuar keto ndryshime statutore te propozuara nga ana e Agjensise AKDIE.

Vendimin nr.3, date 18.12.2017 se bashku me liste - prezencen e anetareve ne Mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme te AKDIE.

Te behen shenimet perkatese ne regjistrin e Organizatave Jofitimpruese prane Gjyqates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

GJYQTARE

ARJANA GUNBARDHI (CACO)





Agjencia e administrimit kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues/ekzekutues

AKDIE

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ARTISTËVE

Adresa: Bulevardi "Bajram Curri" Pall. Agimi, shk. 14, hyrja 259

Site : www.akdie.org ; email: a.k.d.i.e.albania@gmail.com

AKDIE

AGJENCIA E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË ARTISTËVE

INTERPRETUES DHE EKZEKUTUES

STATUTI

DATA 27/07/2017

PREAMBULA

1. Ky statut është në përputhje me rregullat ndërkombëtare, në rast konflikti, me ndonjë rast apo dispozitë statutore teknike, kanë epërsi juridike dhe do të vendoset sipas rregullave ndërkombëtare, sa kohë AKDIE, përfaqëson edhe artistë shqiptarë apo të huaj, jo anëtarë nënshkrues të këtij statuti apo të mandatit të përfaqësimit, të dhënë në formë të shkruar, me nënshkrimin e këtij statuti apo të një Kontrate të shkruar, si AKT-DIJENIE e këtij statuti, që autorizon AKDIE, të kryejë administrim kolektiv të të drejtave të artistëve.
2. Ky statut është në përputhje me legjislacionin specifik shqiptar, për të drejtën e autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të dhe për organizatat jofitimprurëse në Republikën e Shqipërisë.
3. Cdo rrethanë e përcaktuar në nenet përkatëse të ligjit specifik në fuqi, sipas kohës së ngjarjes juridike, për të drejtën e autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të dhe ligjit për organizatat jofitimprurëse, konsiderohet normë e këtij statuti dhe përbën normë

detyruese, si të jetë e shkruar në këtë statut, duke shmangur cdo lloj rasti konflikt normash statutore me ligjin në fuqi.

4. Termat "AAK" ose "Një organizatë e administrimit kolektiv" është në kuptimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv, AKDIE, por për shkak të ligjit në fuqi, drejtën e autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të dhe legjislacionit ndërkombëtar, ka kuptimin edhe të atij entiteti juridik, shqiptar apo të huaj, shoqatë, organizatë, qëndër, fondacion, organizatë jofitimprurëse, që legjislacioni i origjinës, i njeh të drejtën për administrim kolektiv, për të drejta individuale dhe/apo kolektive.
5. Mbledhja e të ardhurave, shpërndarja e tyre dhe shpenzimet, bazohen dhe ndjekin këtë rradhë të zbatimit të ligjit :
 - i. Në Kodin Civil, neni 605 "Rradha e Preferimit".
 - ii. Në legjislacionin ndërkombëtar, me fuqi të ligjit, në Republikën e Shqipërisë.
 - iii. Në legjislacionin në fuqi, drejtën e autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të.
 - iv. Në legjislacionin tatimor.
 - v. Në legjislacionin për organizatat jofitimprurëse.
 - vi. Në cdo akt ligjor dhe nënligjor, me fuqi detyruese për Agjencinë AKDIE.
 - vii. Në këtë Statut.

I. NENI 1- FORMA E ORGANIZIMIT, EMËRTESA, EMRI, SIGLA DHE SIMBOLI I VEÇANTË I ORGANIZATËS;

1. "Agjencia e Administrimit Kolektiv të të Drejtës së Artistëve Interpretues dhe/ose Ekzekutues" "AKDIE" është person juridik, e themeluar fillimisht, si një organizatë jo fitimprurëse me anëtarësi, e krijuar me vullnetin e lirë të artistëve interpretues/ekzekutues, pa asnjë qëllim fitimi, jo qeveritare dhe e pavarur, e cila me marrjen e Licensës nga organi kompetent licensues, sipas ligjit për të drejtën e autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të, ushtron personalitetin juridik të saj, në një veprimtari specifike-ADMINISTRIM KOLEKTIV, jo vetëm për artistët, anëtarë statutor, por edhe për artistët jo nënshkruer të statutit, por artistët e pronësisë artistike, sipas licensës së dhënë, sipas ligjit të kohës, sipas qëllimit të saj.


2. Emërtimi i agjencisë do të jetë "Agjencia e Administrimit Kolektiv të të Drejtës së Artistëve interpretues dhe/ose ekzekutues, "AKDIE", që do të thotë "Akt-dije".
3. Agjencia do të pajiset me vulën vezake të kuqe me gërma kapitale, me të njëjtin emër inicial "AKDIE", që do të përdoret për vendimet, vërtetimet, ftesë zyrtare, shkëmbimet shkresore, etj.
4. Agjencia ka siglën e saj.
5. Vula e Agjencisë, është mjet i mjaftueshëm për të shprehur vullnetin juridik të agjencisë, së bashku me nënshkrimin e Drejtorit Ekzekutiv, për çdo akt shkresor të agjencisë, i njëjtë nga fuqia, si një vulë e noterit publik.
6. Vula disponohet nga Drejtori Ekzekutiv dhe ai është i vetmi përgjegjës në kuptim administrativ, civil ose penal, për përdorimin e saj.

II. NENI 2- QËLLIMI DHE OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË ORGANIZATËS;

1. Qëllimi ekskluziv dhe i vetëm i Agjencisë "AKDIE", si agjencia e vetme shqiptare për të administrimin kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues dhe ekzekutues është **administrimi** kolektiv i të drejtave të artistëve interpretues dhe/ose ekzekutues, të cilët konsiderohen anëtarë që kanë nënshkruar statutin, sipas ligjit për organizatat jofitimprurëse dhe kodit civil, për shoqatat apo kontratat e domosdoshme ligjore-si akt dënie,
 - **duke mbledhur apo arkëtuar** pagesa tek subjektet përdorues të këtyre të drejtave, për shkak të përdorimit masiv të veprave artistike, të cilat shprehen dhe bazohen tek të drejtat e artistëve interpretues/ekzekutues **dhe**
 - **shpërndarjen** e vlerave financiare të këtyre pagesave të mbledhura, vetëm tek ata artistë, shqiptarë ose të huaj, të drejtat e të cilëve kanë krijuar vlera monetare dhe të cilët janë të përfaqësuar nga AKDIE për shkak të kontratave, ligjit apo kontratave të përfaqësimit reciprok, në veprimtaritë tregtare të subjekteve tatimpagues, si edhe kur ato do të mund të krijojnë këto vlera monetare, sipas legjislacionit në fuqi,
 - **përfashtuar** shpërblimet e tjera, që burojnë nga ligji për organizatat jofitimprurëse, për prezencë apo kontribut të posacëm, të anëtarit të një organizate jofitimprurëse.

III. NENI 3-PËRFAQËSIMI PËR ADMINISTRIMIN E TË DREJTAVE

1. Administrimi kolektiv i të drejtave të përmendura në nenet 130 dhe 131, të ligjit 35/2016, në lidhje me të njëjtën kategori të mbajtësve të së drejtës, i jepet nga ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit vetëm një subjekti (AAK), i cili:



a) ka marrë pëlqimin për kryerjen e administrimit të të drejtave nga ana e shumicës së mbajtësve të të drejtave të kësaj kategorie, të cilët i kanë dhënë kompetencat e tyre të përfaqësimit për administrimin e të drejtave të tyre;

b) ka numrin më të madh të kontratave të lidhura me agjencitë reciproke të huaja, në përputhje me kriteret profesionale të përmendura në këtë ligj.

2. Presumohet se agjencia e përmendur në pikën 1, të këtij neni, ka kompetencat e përfaqësimit të të gjithë mbajtësve të së drejtës, vendas dhe të huaj, për të drejtat përkatëse respektive. Mbajtësit e të drejtave do të kenë të drejtë të zgjidhin autorizimin për të administruar të drejtat e tyre mbi veprën, dhënë prej tyre për një AAK, ose të tërheqin ndonjë prej të drejtave të tyre për të mos u administruar nga AAK-ja, në përputhje me nenin 132, të këtij ligji, për vendin e zgjedhur nga ana e tyre, duke bërë njoftimin e duhur, në formë të shkruar, jo më shumë se 6 muaj përpara. AAK-ja mund të vendosë që një zgjidhje ose tërheqje e tillë të hyjë në fuqi vetëm në përfundim të vitit financiar.

3. Agjencia, në vijim të kërkesës së përdoruesit, informon këtë të fundit për ata mbajtës të të drejtave, të cilët ia kanë hequr të drejtën e administrimit, sipas procedurave të pikës 2 të këtij neni.

4. Çdo autor/mbajtës i të drejtave të autorit ose i të drejtave të lidhura me to mund t'i besojë me mandatin e administrimit të të drejtave të tij një agjencie të administrimit kolektiv, e cila nuk mund të refuzojë dhe është e detyruar të pranojë administrimin e këtyre të drejtave, në bazë të administrimit kolektiv, brenda kufirit të objektit të saj të veprimtarisë.

IV. NENI 4- ADMINISTRIMI KOLEKTIV I TË DREJTAVE TË ARTISTËVE NË VEPRËN E INTERPRETUAR APO EKZEKUTUAR.

1. Agjencia e administrimit kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues/ekzekutues "AKDIE", **nuk ushtron të drejtat pasurore dhe jo pasurore, individuale të artistit**, të cilat çdo artist i ushtron drejtpërdrejtë, sipas kontratave të punës ose të porosisë tek punëdhënësi ose tek porositësi, të cilët janë persona fizikë ose juridikë, subjekte tatimpagues të ligjshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Agjencia "AKDIE" nuk ndërhyr në marrëdhëniet e posacme artist- Punëdhënësi-Porositës, por me vendimin e Këshillit Ekzekutiv, sipas kërkesës së shkruar të të gjithë artistëve, të veprës si të tërë, ndërhyr me të gjitha mjetet ligjore për të garantuar vullnetin e artistëve të cënuar nga këto marrëdhënie juridike.

3. Agjencia "AKDIE" administron të drejtat e artistëve interpretues/ekzekutues, të cilat nuk jepen apo nuk mund të jepen në mënyrë individuale dhe të drejtëpërdrejtë, por vetëm ato të drejta, që rrjedhin nga përdorimi masiv i veprës artistike, si të tërë,

- (i) duke garantuar shpërblimin e çdo artisti, sipas rregullave statutore dhe kontributit të tyre specifik, në veprën artistike si të tërë,
- (ii) duke garantuar përdorimin e këtyre të drejtave nga ana e përdoruesve masiv, kundrejt pagesës përkatëse.

4. Subjekti përdorues i të drejtave të artistëve, janë subjektet tatimpagues, me objekt veprimtarie tregtare të përcaktuar në legjislacionin tatimor, të cilët përdorin vepra artistike, në veprimtarinë e tyre, me qëllim përfitimi financiar, ku:

- 1) përdorimi i të cilave ka ndikim themelor ose kryesor në të ardhurat e tyre, si tatimpagues me aktivitet radio, televizione, platforma televizive dixhitale ose jo, me ose pa kabëll, satelitore, tokësore, analoge, valore, ofrues të përmbajtjeve të veprave artistike në internet, në valët e telefonisë së lëvizshme, etj, sipas teknologjisë aktuale ose të ardhshme.
- 2) ose ndikim dytësor ose ndihmës, në të ardhurat e tyre, si tatimpagues me aktivitet bar, restorant, hotel, motel, fshatra turistik, qendra tregtare, e të ngjashme me këto kategori, sipas veprimtarive tregtare, të njohura nga legjislacioni tatimor.

5. Agjencia "AKDIE" përfaqëson ligjërisht të drejtat e artistëve interpretues/ekzekutues, shqiptar apo të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas ligjit dhe sipas Kontratave të Përfaqësimit Reciprok, jashtë këtij territori.

6. Agjencia "AKDIE", për çdo procedurë ligjore dhe gjyqësore gëzon legjitimitet aktiv dhe, në legjislacionin penal, është në pozitën e të dëmtuarit :

- 1) për shkak të ligjit për të drejtën e autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të dhe licensës specifike të dhënë nga organi kompetent, për veprimtarinë e administrimit kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues/ekzekutues, si një akt shkresor zyrtar i Ministrisë përgjegjës, i shprehur shprehimisht nga ligji, për administrim degë apo fushë arti, licensë e **cila ka vlerën e prokurës, sipas Kodit Civil**, duke i dhënë personalitetit të saj juridik, një karakter të mëvetsishëm, si një institucion i pavarur, me të drejta specifike, të drejta të cilat mund të cënohen dhe duhen mbrojtur, sipas ligjit shqiptar dhe ndërkombëtar.
- 2) për shkak të këtij statuti, në zbatim të të drejtave, që burojnë nga Kushtetura, Kodi Civil dhe ligji në fuqi, për organizatat jofitimprurëse, agjencia AKDIE, vepron në emër të saj apo edhe

The bottom of the document features several handwritten signatures in black ink. One signature is notably larger and more stylized, appearing to be 'Kard' with a small '5' above it. To the right, there is a large, complex signature that looks like 'G. N. ...'. There are also some smaller, less legible signatures and what appears to be a stamp or official mark on the right side.


në emër të anëtarësisë së saj, për të administruar, përfaqësuar, mbrojtur dhe për të kryer çdo veprim juridik të njohur nga ligji, në përputhje me ligjin, në mënyrë të lirë dhe të pavarur.

- 3) Për shkak të këtij statuti dhe legjislacionit tatimor, Agjencia AKDIE është agjente e mbajtjes së tatimit në burim dhe, sipas legjislacionit tatimor, Agjencisë AKDIE, i kërkohet të llogarisë, të mbajë tatimin në burim për një tatimpagues, të raportojë dhe t'i transferojë këto tatime në Buxhetin e Shtetit, për çdo detyrim tatimor të lindur për shkak të përdorimit të të drejtave të artistëve të saj,
- (i) të cilët janë anëtar statutor, nënshkruar të STATUTIT dhe KONTRATAVE individuale me AKDIE
- (ii) janë të përfaqësuar nga AKDIE dhe AKDIE ushtron, mbron dhe i përfaqëson ata, për shkak të Kontratave të Përfaqësimit Reciprok, me Agjencitë e huaja, sipas legjislacionit ndërkombëtar.
- (iii) Presumohet se AKDIE ka kompetencat e përfaqësimit të të gjithë mbajtësve të së drejtës, vendas dhe të huaj, për të drejtat përkatëse respektive. Mbajtësit e të drejtave do të kenë të drejtë të zgjidhin autorizimin për të administruar të drejtat e tyre mbi veprën, dhënë prej tyre për një AAK, ose të tërheqin ndonjë prej të drejtave të tyre për të mos u administruar nga AAK-ja, në përputhje me nenin 132, të ligji 35/2016, për vendin e zgjedhur nga ana e tyre, duke bërë njoftimin e duhur, në formë të shkruar, jo më shumë se 6 muaj përpara. AAK-ja mund të vendosë që një zgjidhje ose tërheqje e tillë të hyjë në fuqi vetëm në përfundim të vitit financiar.

V. NENI 5-FUNKSIONET, TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AKDIE

AKDIE, për llogari të mbajtësve të të drejtave dhe në bazë të kompetencave që i janë dhënë dhe sa parashikohet në ligjin nr. 35/2016, ka këto funksione:


- a) t'u jap përdoruesve, në vijim të kërkesave të tyre, kontrata në formën joekskluzive për përdorimin e veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura, në këmbim të një shpërblimi, me kontratë të shkruar, brenda tagrave të përcaktuar në licencën e agjencisë;
- b) të mbledh shpërblimin për përdorimin e veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura;
- c) të shpërndajë, në bazë të rregullave të shpërndarjes, shpërblimin e mbledhur nga përdoruesit në mënyrë të drejtë dhe të përpjesëtuar me vlerën dhe përdorimin aktual të veprave e të objekteve të të drejtave të lidhura. Parimet e shpërndarjes së shpërblimit përcaktohen në statutin e agjencisë dhe do të përjashtohet çdo mundësi arbitrare;

The bottom of the page contains several handwritten signatures in black ink. There are also some faint, illegible stamps or markings. The signatures appear to be from various individuals, possibly representing different departments or the organization as a whole. The overall appearance is that of a formal document with multiple approvals.

- c) të përfaqësojë mbajtësit e të drejtave, të drejtat e të cilëve AKDIE administron, në procedurat gjyqësore ose administrative dhe të kryejë çdo veprim tjetër ligjor të nevojshëm për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të administruara nga ajo;
- d) të kryejë çdo veprim tjetër, në përputhje me tagrat e saj ligjore dhe të organeve të veta vendimmarrëse, për kompetencat e marra nga mbajtësit e të drejtave;
- dh) të hartojë metodologji të negociueshme për përcaktimin e nivelit të tarifave që subjektet përdoruese duhet të paguajnë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- e) të realizojë në emër të artistit ose të mbajtësit të së drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të ose në bazë të kontratës së reciprocitetit me agjenci të huaja të ngjashme marrëveshjet e përgjithshme me organizatorët e shfaqjeve, me ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv, me operatorët e rrjetit numerik, që kanë si objekt autorizimin e shfaqjes dhe shpërndarjes për veprat që administron;
- ë) të përfaqësojë interesat e anëtarëve për shfrytëzimin e të drejtave, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke nënshkruar kontratat e reciprocitetit me agjenci të huaja të ngjashme;
- f) të informojë, sipas kërkesës, mbajtësit e të drejtave të autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me to për mënyrën e shfrytëzimit të të drejtave të tyre, për raportin vjetor financiar dhe atë të kontrollit të të ardhurave financiare, brenda kohës së parashikuar në statut;
- g) të sigurojë transparencën e veprimtarisë së agjencisë së administrimit kolektiv, në lidhje me autoritetet publike të kontrollit, sipas ligjit;
- gj) për të ardhurat e mbledhura nga përdoruesit dhe që u paguhet në formë shpërblimi mbajtësve të të drejtave, kjo agjenci detyrohet të mbajë dhe të paguajë për llogari të administratës tatimore tatimin në burim, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat;
- h) për efekt të përcaktimit të saktë të detyrimeve tatimore, ka detyrimin të vendos në dispozicion të administratës tatimore, sipas formateve të miratuara, informacionin mbi të ardhurat e mbledhura nga përdoruesit e veprave të të drejtave të autorit/të lidhura me to, si dhe shpërndarjen e këtyre shpërblimeve të mbajtësit e të drejtave.

VI. NENI 6-TË DREJTAT E ADMINISTRUESHME NGA AGJENCIA "AKDIE" DHE ADMINISTRIMI I TË DREJTAVE PËRMES AGJENCIVE.

1. Agjencia e Administrimit Kolektiv ka të drejtë dhe administron vetëm ato të drejta, të cilat nuk mund të ushtrohen, nuk mund të mbrohen dhe nuk mund të përfaqësohen, në mënyrë të mëvetsishme nga njeriu artist, konsideruar veprën si të tërë dhe kontributin e tij në vepër, të lidhur pazgjidhshmërisht dhe të shkrirë, në mënyrë të padallueshme, në veprën artistike si




të tërë, duke garantuar qarkullimin masiv, të lirë dhe të ligjshëm të veprës artistike, konsideruar numrin, shtrirjen territoriale të mijëra subjekteve përdorues, brenda dhe jashtë Shqipërisë, ku përdoret vepra artistike, si e tërë.

2. Agjencia "AKDIE", administron, ushtron dhe përfaqëson juridikisht, në formë të ligjshme, sipas legjislacionit në fuqi, në territorin e Shqipërisë, sipas legjislacionit europian dhe normave ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është anëtare, SI TITULLARE E VETME E LIGJSHME, të drejtat e artistëve interpretues dhe ekzekutues, me të gjitha format që njeh dhe do të njoh teknologjia, të përcaktuar në ligjin në fuqi, për të drejtën e autorit dhe të të drejtave të tjera, të lidhura me të.
3. Agjencia e administrimit kolektiv të të drejtave mund të administrojë një, dy ose më shumë lloje të drejtash që zakonisht lidhen me një kategori të veçantë të mbajtësve të të drejtave të autorit ose të të drejtave të lidhura me to.
4. Agjencia mund të kalojë një ose disa funksione, në lidhje me administrimin e të drejtave pranë ndonjë agjencie tjetër të administrimit kolektiv, sipas këtij ligji, me anë të një marrëveshjeje me shkrim, të miratuar paraprakisht nga ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit.
5. Agjencia, së cilës i kalojnë funksionet e përmendura më sipër, ushtron këto funksione në emër dhe për llogari të agjencisë që i ka transferuar ose në emër të vet dhe për llogari të agjencisë që i ka kaluar këto të drejta, sipas mënyrës së përcaktuar në marrëveshjen midis tyre.

VII. NENI 7-ANËTARËSIA

Agjencia "AKDIE", marr në konsideratë :

1. Pjesëmarrjen e detyrueshme të saj, në organizatat ndërkombëtare të administrimit kolektiv të të drejtave të artistëve, duke qënë pjesë e këtij sistemi, me qëllim shpërblimin e artistëve shqiptar dhe të huaj, njëloj, pa dallim diskriminimi, nga përdorimi i të drejtave të artistëve, të cilat sjellin pasojë pozitive ekonomike për përdoruesit masiv të të drejtave, krijojnë efekt financiar për buxhetin e shtetit, për detyrimin tatimor të lindur, për shkak të përdorimit të të drejtës së artistit dhe pagesa shpërblyese, i jepet vetëm artistit, shqiptar ose të huaj, për shkak të përdorimit specifik të të drejtës së tij, në veprën artistike, e cila është përdorur/komunikuar/është vendosur në dispozicion të publikut, në mënyrë ndërvepruese,



gjatë vitit kalendarik, duke ndikuar në mënyrë financiare, tek subjektet tatimpagues, përdorues të këtyre të drejtave.


2. Ligjin për organizatat jofitimprurëse, si dhe dispozitat e Kodit Civil, për shoqatat,

Agjencia "AKDIE" njeh dhe pranon si anëtarë të saj :

1. Aktorët
2. Këngëtarët
3. Muzikantët
4. Valltarët
5. Drejtues orkestre
6. Drejtues kori
7. Personat që luajnë një rol mbështetës në interpretim/ekzekutim, por të rëndësishëm;
8. Prezantuesit
9. Recituesit
10. Spikerat

Sipas këtyrë përkufizimeve:

1. Anëtar i agjencisë "AKDIE" është dhe do të konsiderohet çdo person artist, shtetas shqiptar, i cili ka interpretuar/ekzekutuar në një vepër artistike, të çdo lloj zhanri artistik, vepër e cila i është përcjellë publikut ose është vendosur në dispozicion publikut, në mënyrë ndërvepruese, më të gjitha format që njeh ose do të njoh teknologjia, në mënyrë masive, gjatë vitit kalendarik të mëparshëm dhe i cili/e cila, **nëpërmjet kontratës që ka me agjencinë AKDIE**, arkëton pagesat në numrin e llogarisë së tij bankare, brenda afatit 3 vjeçar, kur shuhet e drejta e kërkimit gjyqësor, sipas afatit parashkrimit të padisë, nga viti kalendarik kur është përdorur interpretim/ekzekutimi i tij, në veprën artistike, sipas skemës së Mbledhjes së Pagesave, sipas përdorimit të të drejtave të artistëve, sipas veprave të përdorura gjatë minutazhit të vitit kalendarik (525 600 minuta). **Prezumohet se agjencia AKDIE**, ka kompetencat e përfaqësimit të të gjithë mbajtësve të së drejtës së artistëve, vendas dhe të huaj, për të drejtat përkatëse respektive në veprën artistike të përdorur. Mbajtësit e të drejtave do të kenë të drejtë të zgjidhin autorizimin për të administruar të drejtat e tyre mbi veprën, dhënë prej tyre tek AKDIE, sipas kontratës dhe/ose sipas licensës së dhënë nga Autoriteti licensuar, ose të tërheqin ndonjë prej të drejtave të tyre, për të mos u administruar nga AKDIE, në përputhje me ligjin, për vendin e zgjedhur nga ana e tyre, duke bërë njoftimin e duhur, në formë të shkruar, jo më shumë se 6 muaj përpara. AKDIE mund të vendosë që një zgjidhje ose tërheqje e tillë, të hyjë në fuqi vetëm në përfundim të vitit financiar, sepse

The bottom of the page features several handwritten signatures in black ink. There are approximately seven distinct signatures, some of which are quite stylized and overlapping. The signatures are located below the main text and above the page number '9'.

Agjencia AKDIE ka detyrimin e arktëtimit të pagesave për 365 ditë të vitit kalendarik, që do të thotë :

- 1) 365 ditë X 24 orë X 60 minuta = 525 600 minuta.
- 2) një vepër muzikore ka 3 minuta
- 3) një vepër audiovizuale ka 30-120 minuta
- 4) një vepër kinematografike ka 120 minuta.
- 5) Në vit, matematikisht, përdoren :
- 6) 175 200 vepra muzikore- (1 këngëtar-3 korrista-6 instrumentista)= **1 750 000** artistë shqiptarë dhe të huaj.
- 7) 4380 filma- (1-aktor kryesor, 10 aktorë dytësor, 1 këngëtar-3 korrista-6 instrumentista) 20 artistë= **87 600** artistë shqiptarë dhe të huaj
- 8) 17520 lajme, spektakël, etj

2. Anëtar i agjencisë "AKDIE" është dhe do të konsiderohet çdo person artist -shtetas i huaj, i cili kërkon me akt të shkruar, i shoqëruar me dokumentacionin e duhur, se dëshiron të jetë anëtar i Agjencisë AKDIE dhe pranohet si i tillë, me Vendim të Këshillit Ekzekutiv dhe Asamblesë së Përgjithshme, vetëm pasi të ketë provuar me aktet shkresore, të njohura si të tilla nga legjislacioni ndërkombëtar, se nuk është anëtar i asnjë agjencie tjetër, të vendit të origjinës së tij ose se ka tërhequr të drejtat e tij, nga administrimi i asaj agjencie dhe nuk ka asnjë problem ligjor me atë agjenci dhe nëpërmjet kontratës së firmosur me agjencinë AKDIE kalon të drejtat e tij për administrim kolektiv pranë saj.

3. Anëtar i Agjencisë "AKDIE" është dhe do të konsiderohet çdo artist i huaj, i përfaqësuar në Shqipëri nëpërmjet Kontrata të Përfaqësimit reciprok me shoqëritë homologe përkatëse të huaja, i cili ka interpretuar/ekzekutuar në një vepër artistike, të çdo lloj zhanri artistik, vepër e cila i është përcjellë publikut ose është vendosur në dispozicion publikut, në mënyrë ndërvepruese, në mënyrë masive, brënda afatit ligjor të mbrojtjes së të drejtës së artistit.

VIII. NENI 8- KOHËZGJATJA

1. Afati i veprimtarisë së agjencisë, si organizatë jofitimprurëse është i papërcaktuar.
2. Licenca e agjencive të administrimit kolektiv për ushtrimin e veprimtarisë së administrimit kolektiv është e vlefshme për 3 vjet, e rinovueshme.
3. Procedura e marrjes së licencës apo ripërtëritjes së saj i nënshtrohet të njëjtave kritere të parashikuara në këtë ligj apo në akte të tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji dhe kryhet


The bottom of the page features several handwritten signatures in black ink, some of which are crossed out with a large 'X'. There are also some faint, illegible markings and what appears to be a stamp or official mark on the right side.

nëpërmjet një procesi publik, i cili siguron zbatimin e parimeve të transparencës dhe të konkurrueshmërisë.

IX. NENI 9- TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARËVE NDAJ AGJENCISË DHE KRITERET PËR HUMBJEN OSE FITIMIN E ANËTARËSISË

Cdo artist interpretues dhe / ose ekzekutues, i cili është anëtar i agjencisë është i detyruar :

1. Të respektojë dhe të veprojë në përputhje me Statutin e Agjencisë, për të cilin ai deklaron se e njeh dhe e respekton atë.
2. Të mos bëj asnje marrëveshje në kundërshtim me ligjin, në formë individuale, në dëm të interesave të Agjencisë.
3. Të mos përdor pozitën e tij, në konflikt interesi me agjencinë.
4. Të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Artistëve dhe kur është i zgjedhur, edhe në Këshillat e Agjencisë, duke respektuar rregullat statutores, kodin e etikës dhe legjislacionin në fuqi.
5. Mosmarrja pjesë, për më shumë se 3 herë rradhazi, në Asamblenë e Përgjithshme ose, kur është i zgjedhur, në Këshillat e agjencisë, pa arsye të ligjshme, i jep të drejtën Këshillit Ekzekutiv, për t'ia hequr artistit, të drejtën e përfitimit nga fondet e shpërblyeme rezervë, të krijuara sipas këtij statuti, me qëllim mos rrezikimin e portofolit financiar të agjencisë.
6. Të depozitojë në Rregjistrin Elektronik dhe të shkruar të Agjencisë, veprat artistike, ku ai ka kontribuar, si artist, me interpretimet dhe ekzekutimet e tij. _____
7. T'i nënshtrohet, në bazë të Statutit, vendimeve të Këshillave të Agjencisë;
8. Çdo anëtar është i detyruar, me kërkesë të agjencisë, të paraqesë çdo dokument që provon kontributin e tij, si artist, në një vepër të caktuar artistike.
9. Është e ndaluar dhe përbën shkelje të rëndë statutores, me pasojë përjashtimin automatik nga antarësia statutores, me Vendim të Këshillit të Ankesave, cdo veprim që mund të çënojë interesat pasurore dhe jopasurore të Agjencisë dhe anëtarëve të saj.
10. Çdo artist, anëtar i agjencisë "AKDIE" ushtron të drejtën e tij, për të qënë anëtar i Agjencisë, me nënshkrimin e Kontratës individuale apo anëtarësisë në shoqërinë simotër me të cilën Agjencia AKDIE ka kontratë të përfaqësimit reciprok.
11. Çdo artist, ka të drejtën e ligjshme të largohet nga agjencia "AKDIE", sipas kërkesës së tij me shkrim, drejtuar Drejtorit Ekzekutiv, i cili e paraqet këtë kërkesë për miratim në Këshillin Ekzekutiv, në mbledhjen më të afërt, vendimmarrja e Këshillit miratohet nga Asambleja e Përgjithshme, në mbledhjen më të afërt.




12. Në rast se kjo kërkesë është urgjent, për shkak se artisti nuk dëshiron të jetë anëtar i "AKDIE" ose sepse ka gjetur një mbrojtje efektive më të mirë, për të drejtat e tij, por pa cënuar në asnjë rast të drejtat e artistëve të tjerë, pjesëmarrës në veprat e tij artistike, Drejtori Ekzekutiv, miraton këtë kërkesë me shkrim, nën përgjegjësinë e tij, duke zbatuar me përpikmëri procedurën e mësipërme.

13. Çdo artist statutor, mund të përjashtohet nga Agjencia "AKDIE", sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve Artistë, sipas propozimit të Këshillit Ekzekutiv ose të artistëve pjesëmarrës në një vepër artistike të përbashkët me artistin, i cili përjashtohet, për këto shkaqe:

- Fyen, shpif ose dëmton me dashje, grupin e artistëve, të drejtat e artistëve ose agjencinë "AKDIE".
- Përfshihet me dashje, në veprime të kundraligjshme, për të dëmtuar agjencinë "AKDIE".
- Nuk zbaton me ndershmëri, përpikmëri dhe seriozitet Vendimet e Këshillit Ekzekutiv ose të Asamblesë së Përgjithshme.
- Aktet e përjashtimit, i nënshtrohen procedurës gjyqësore, sipas kërkesës së të interesuarit dhe agjencia zbaton në mënyrë vullnetare, vendimin e formës së prerë të gjykatës.

X. NENI 10- KËSHILLI I ANKESAVE PËR ARTISTËT

1. Cdo artist, për të cilin është vlerësuar se e drejta e tij për të marrë informacionin e kërkuar nuk është realizuar, mund t'ia kërkojnë këtë, brenda tri ditëve, komisionit të posaçëm, i përhershëm në lidhje me shqyrtimin e kërkesës për informim, i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, që përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët nuk janë të punësuar dhe nuk janë pjesë e organeve drejtuese.
2. Komisioni është i detyruar t'i përgjigjet, brenda shtatë ditëve, për bazueshmërinë e këtyre pretendimeve, si ankuesit që ka depozituar ankesën edhe drejtuesit të agjencisë.
3. Komisioni do të hartojë çdo vit një raport për veprimtarinë e tij, i cili do të dorëzohet në mbledhjen e përgjithshme të agjencisë dhe pranë DDA-së.
4. Këshilli i Ankesave përbëhet nga pesë anëtarët më të vjetër në moshë të Agjencisë dhe kryetari është personi më i moshuar midis tyre.
5. Votimi në komision është i hapur dhe kryhet pas vlerësimit të ankesës së artistit.
6. Komisioni mbledhet dhe vendimet e tij janë të vlefshme, edhe në rast se mungojnë dy anëtarë, mjafton të sigurohet kuorimi prej tre anëtarësh dhe të ketë mundësi të vendoset për kërkesën.



XI. NENI 11-PARIMET PËR KRIJIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT NGA TARIFAT DHE RREGULLAT E PËRCAKTUARA PËR REALIZIMIN E MBLEDHJES

1. Në qoftë se përdorimi i objektit të mbrojtjes është i domosdoshëm për aktivitetin e një përdoruesi dhe kur aktiviteti i tij varet nga ky përdorim, si në rastet e transmetimeve, koncerteve, valleve ose përdorimeve të tjera të objektit kundrejt pagesës, shuma e shpërblimeve do të jetë fikse në parim, si përqindje e të ardhurave ose fitimit nga një përdorim i tillë.

2. Nëse përdorimi i objektit të mbrojtjes rezulton pa të ardhura ose fitim, shuma e pagesave mund të jetë fikse, si përqindje e shpenzimeve të përdorimit, të tilla si shpërblimet ose pagat e interpretuesve apo shpenzimet e bëra për përdorimin, shfrytëzimin e lokaleve ose shpenzime të tjera.

3. Përveç shpërblimeve fikse, si përqindje, shuma minimale e shpërblimeve specifikohet.

4. Nëse një përdorues nuk dorëzon tek AKDIE informacion të nevojshëm për përcaktimin e shpërblimit si përqindje, AKDIE mund të vendosë sasinë e shpërblimeve, në bazë të informacionit të mbledhur, në përputhje me nenin 141 të ligjit nr. 35/2016.

5. Nëse përdorimi i objektit të mbrojtjes nuk është thelbësor për një përdorues, por është i dobishëm ose çlodhës (objektet e akomodimit, vende ekspozitë, mjetet e transportit dhe objekte të caktuara hoteleri), shuma e shpërblimeve përcaktohet si një shumë totale për përdorime të përhershme dhe rastësore.


6. Në rastin e një vendimmarrjeje për shumën totale dhe shpërblimet e përmendura në pikën 3, të këtij neni, rrethanat e përdorimit të objektit të mbrojtjes, që merren në konsideratë, do të jenë tipi i përdorimit, vendi dhe vendndodhja gjeografike, kategoria dhe madhësia e objekteve, kohëzgjatja dhe numri i përdorimit dhe diferenca e çmimeve në lidhje me biznesin e një përdoruesi.

XII. NENI 12-SHPËRNDARJA E TARIFAVE TË SHPËRBLIMIT

1.Përdoruesi i paraqet AAK-së informacion të plotë, në lidhje me vendin dhe kohën e përdorimit të një objekti të mbrojtjes, për qëllime të shpërndarjes së shpërblimeve të grumbulluara. Ky informacion jepet:

- a) paraprakisht;
- b) deri në 15 ditë pas përdorimit;
- c) sipas kontratës.

2.Në rast se shpërndarja nuk është e mundur, në bazë të informacionit për përdorimin ose në qoftë se kjo shpërndarje rezulton dukshëm joekonomike, ajo mund të kryhet nga aplikimi i metodave statistikore që korrespondon me masën më të madhe të përdorimit aktual.



3. Shpërndarja e shpërblimeve të grumbulluara për mbajtësit e të drejtave kryhet në përputhje me informacionin mbi përdorimin e objektit të mbrojtjes.

XIII. NENI 13-RREGULLA NË LIDHJE ME SHPËRNDARJEN E SHPËRBLIMEVE

1. AKDIE parashikon rregulla në lidhje me metodologjinë e shpërndarjes së shpërblimeve të grumbulluara, siç janë miratuar nga organi i saj vendimmarrës.

2. Në këto rregulla duhet të mbahen parasysh:

- a) objekti i mbrojtjes dhe mbajtësit e të drejtave, për të cilat zbatohen këto rregulla;
- b) përcaktimi i kriterëve dhe procedurës së shpërblimeve, me qëllim stimulimin e mbajtësve të të drejtave, veprat e të cilëve përfaqësojnë një vlerë të veçantë për kulturën dhe krijimtarinë kombëtare, paraprakisht të miratuara nga KKDA-ja;
- c) përcaktimi i shumave që duhet të paguhen pas zbritjes së kostos për administrimin e së drejtës, ndarja e fondeve të parashikuara nga ligji, nga statuti i AAK-së ose nga kontratat ndërkombëtare për përfaqësimin e përbashkët të AAK-ve;
- c) kushtet për llogaritjen dhe pagesën e shpërblimeve të shpërndara.

3. Shpërblimet e mbledhura përdoren në përputhje me rregullat e referuara në pikën 2, të këtij neni, dhe parashikimet e këtij ligji.

4. Kontratat për shpërndarjen, të lidhura midis mbajtësve të së drejtës për të njëjtën vepër, konsiderohen shkelje të rregullave të shpërndarjes.

5. Shpenzimet totale të një AAK-je nuk mund të përbëjnë më shumë se 30 për qind të shpërblimeve të shpërndara. Shuma e përgjithshme e shpenzimeve të një shoqate apo çdo forme tjetër juridike OJF-je do të përfshijë edhe mjetet financiare të shpenzuara në përmirësimin e sistemit të administrimit dhe mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe të të drejtave të lidhura me të. Përveç shpenzimeve të tilla të bëra, organet e agjencisë mund të vendosin për të shpenzuar maksimumi 3 për qind të shumës totale të shpërblimeve të grumbulluara mbi masat kundër piraterisë dhe falsifikimit, si dhe për masat e tjera që kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të vlerës së të drejtës së autorit dhe të të drejtave të lidhura me të.

6. Llogaritja dhe shpërndarja e shpërblimeve bëhen të paktën një herë në vit.

7. Bilancet e ushtrimit financiar, në lidhje me shpërndarjen, përcaktohen nga një organ kompetent i agjencisë dhe duhet të jenë të audituara e të vlerësuara nga një ekspert auditi.

8. AAK-ja, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së raportit të auditimit, do t'i dorëzojë DDA-së deklaratën e saj të llogarisë, në lidhje me shpërndarjen, referuar pikës 7 të këtij neni.

The bottom of the page contains several handwritten signatures in black ink, some of which are crossed out with a diagonal line. There are also some faint, illegible stamps or markings scattered across the bottom section.

9. Tarifat e shpërblimeve të mbledhura nga përdoruesit, të cilat në përfundim të vitit financiar nuk shpërndahen nga AAK-ja, depozitohen në një fond special për llogari të ministrisë përgjegjëse për të drejtat e autorit, në dispozicion të titullarëve të të drejtave të autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me to për një periudhë 3-vjeçare. Gjatë kësaj periudhe, nëse AAK-ja identifikon mbajtësin e së drejtës, siguron shpërndarjen dhe përfiton edhe tarifën e administrimit. Në rast se mbajtësi nuk identifikohet për një periudhë trevjeçare, fondi special i kalon ministrisë përgjegjëse për të drejtat e autorit, e cila do ta përdorë në përmbushje të objektivave të saj për rritjen e krijimtarisë dhe diversitetin kulturor.

10. Një kopje e bilanceve të miratuara dhe të audituara, në përputhje me pikat 7 dhe 8, të këtij neni, depozitohen pranë administratës tatimore sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi të ardhurat.

XIV. NENI 14-METODA E MBLEDHJES DHE E SHPËRNDARJES

1. Agjencia AKDIE, zbaton me përpikmëri metodën e mbledhjes dhe të shpërndarjes, të parashikuar në ligjin në fuqi për të drejtën e autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të.
2. Agjencia AKDIE ka detyrimin e arktëtimit të pagesave për 365 ditë të vitit kalendarik, që do të thotë për 365 ditë X 24 orë X 60 minuta = 525 600 minuta.
3. Për efekt përlogaritje, një vepër muzikore ka një kohëzgjatje në 3 minuta, një vepër audiovizuale ka 30-120 minuta, një vepër kinematografike ka 120 minuta dhe në vit, matematikisht, përdoren :
 - (i) 175 200 vepra muzikore- (1 këngëtar-3 korrista-6 instrumentista)= **1 750 000** artistë shqiptarë dhe të huaj.
 - (ii) 4380 filma- (1-aktor kryesor, 10 aktorë dytësor, 1 këngëtar-3 korrista-6 instrumentista) 20 artistë= **87 600 artistë** shqiptarë dhe të huaj
 - (iii) 17520 lajme, spektakël, etj

MUZIKA

- vepra muzikore, të hedhura në mbajtëse vetëm zëri (Kasetë audio-CD)
 1. Artisti interpretues-Këngëtar-Solist
 2. Artistët intpretues-këngatar Korri.
 3. Artistët ekzekutues-instrumentistët-orkestra, sipas veglave muzikore.

Vlera e veprës e ndarë në përqindje, ndahet rregullisht sipas kontratës së punës ose porosisë, **NË RAST SE NUK JANË SAKTËSUAR KËTO ELEMENTE, ME ANË TË KONTRATËS, NDAHET SI VIJON :**

1. <u>Solisti</u>	25%-35%
2. <u>Korristët</u>	25%-15%
3. <u>Instrumentisti i parë</u>	15%-20%
4. <u>Instrumentitëst e veglave mbështetëse-</u>	35%-30%

➤ vepra muzikore, të hedhura në mbajtëse zëri dhe figure - vepra muzikore audiovizuale-(Kasetë video-DVD)

1. Artisti interpretues-Këngëtar-Solist
2. Aktor kryesor
3. Artistët intepretues-këngëtar Korri
4. Aktorë dytësor
5. Artistët ekzekutues-instrumentistët-orkestra, sipas veglave muzikore.

Vlera e veprës e ndarë në përqindje, ndahet rregullisht sipas kontratës së punës ose porosisë, **NË RAST SE NUK JANË SAKTËSUAR KËTO ELEMENTE, ME ANË TË KONTRATËS, NDAHET SI VIJON :**

1. <u>Solisti</u> aktor kryesor	40%
2. <u>Korristët</u> aktorë dytësor	20%
3. <u>Instrumentisti i parë, pjesëmarrës si aktor</u>	20%
4. <u>Instrumentitëst e veglave mbështetëse-pjesëmarrës si aktorë</u>	20%

➤ Kur vepra muzikore ndahet nga vepra audiovizuale,vlera e veprës e ndarë në përqindje, ndahet rregullisht sipas kontratës së punës ose porosisë, **NË RAST SE NUK JANË SAKTËSUAR KËTO ELEMENTE, ME ANË TË KONTRATËS, NDAHET SI VIJON :**

1. <u>Solisti</u>	25%
2. <u>Korristët</u>	10%
3. <u>Instrumentisti i parë,</u>	10%
4. <u>Instrumentitëst e veglave mbështetëse</u>	10%
5. <u>Aktor kryesor</u>	25%
6. <u>Aktorë dytësor</u>	20%

➤ **FILMI-AUDIOVIZUALI**

Vlera e veprës e ndarë në përqindje, ndahet rregullisht sipas kontratës së punës ose porosisë, **NË RAST SE NUK JANË SAKTËSUAR KËTO ELEMENTE, ME ANË TË KONTRATËS, NDAHET SI VIJON :**

➤ Vepra audiovizuale kinematografike:

❖ Artisti interpretes/ekzekutes (MUZIKA) 30%

Kjo përqindje ndahet, si vlerë totale, si vijon:

i.	<u>Solisti</u>	<u>25%-35%</u>
ii.	<u>Korristët</u>	<u>25%-15%</u>
iii.	<u>Instrumentisti i parë</u>	<u>15%-20%</u>
iv.	<u>Instrumentitëst e veglave mbështetëse</u>	<u>35%-30%</u>

❖ Aktor /aktorët kryesor 40%

❖ Aktorët dytësor[sipas rolit dhe përqindjes së kohës së luajtur] 30%

➤ Vepra audiovizuale televizive, vlera e veprës e ndarë në përqindje, ndahet rregullisht sipas kontratës së punës ose porosisë, **NË RAST SE NUK JANË SAKTËSUAR KËTO ELEMENTE, ME ANË TË KONTRATËS, NDAHET SI VIJON :**

❖ Artisti interpretes/ekzekutes (MUZIKA-KOLONË ZANORE) 40%

Kjo përqindje ndahet, si vlerë totale, si vijon:

1.	<u>Solisti</u>	<u>25%-35%</u>
2.	<u>Korristët</u>	<u>25%-15%</u>
3.	<u>Instrumentisti i parë</u>	<u>15%-20%</u>
4.	<u>Instrumentitëst e veglave mbështetëse</u>	<u>35%-30%</u>

❖ Drejtuesi (spikeri)/drejtuesit e veprës audiovizuale 30%

❖ Grupi koreografik [në rast se ka] 30%

Kjo përqindje ndahet, si vlerë totale, si vijon:

i.	<u>Balerin i parë</u>	<u>35%-50%</u>
ii.	<u>Balerinë mbështetës</u>	<u>65%-50%</u>

17

XV. NENI 15-ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ANËTARËVE ARTISTË DHE PJESËMARRJA MINIMALE PËR ORGANIZIMIN DHE VENDIMMARRJE TË ANËTARËVE STATUTOR


1. Organi më i lartë drejtues vendimmarrës i agjencisë është Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve Artistë të Agjencisë AKDIE, e cila mbledhet, në selinë e Agjencisë "AKDIE" ose në cdo vënd tjetër, për shkak të numërit të madh të anëtarësisë, sipas Kërkesës së Presidentit të Agjencisë AKDIE, bazuar në Vendimin e Këshillit Ekzekutiv, brenda kohës së caktuar për miratimin e veprimtarisë financiare të Agjencisë dhe shpërndarjes së vlerave monetare tek artistët, por në cdo rast jo më pak se një herë në vit.
2. Organi më i lartë vendimmarrës, Asambleja e Artistëve nuk mund të ketë më pak se 5 anëtarë, mbledhet me pjesëmarrjen e 5 anëtarëve të tij dhe vendos, me shumicën e anëtarëve të pranishëm.
3. Në rastet e vecanta, (forca madhore, apo rastet e falimentimit, likuidimit, humbjes së interesit, dështimit të agjencisë, e të tjera si këto rrethana të jashtëzakonshme) kur numri i Asamblesë së Artistëve është i njëjtë me numrin e Këshillit Ekzekutiv, vendimi i Këshillit Ekzekutiv, në atë mbledhje, konsiderohet edhe Vendim i Asamblesë së Përgjithshme.
4. Çdo anëtar statutor, ka të drejtën e një vote të vetme dhe të barabartë me të tjerët, në Asamble të Përgjithshme.
5. Votimi kryhet zakonisht, me prezencë fizike, por, për shkak të rrethanave të vendndodhjes të artistëve, angazhimeve artistike të tyre apo cdo rrethane tjetër të arsyeshme dhe të ligjshme, të pranuar nga Presidenti i Asamblesë, ditën e organizimit të asamblesë, votimi mund të kryhet me Prokurë Përfaqësimi, e dhënë tek noteri publik, me anë të postës elektronike, me anë të mjeteve të teknologjisë të thirrjes telefonike apo video konferencës.
6. Për votimet me postë elektronike, vullneti i anëtarit, quhet i shprehur në adresën elektronike zyrtare të AKDIE.
7. Për votimet me anë të telefonisë apo video konferencës, duhet domosdoshmërisht nënshkrimi i të paktën të dy anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv, për aktin e zbardhjes së vullnetit nga ana e administratës së AKDIE, në cilësinë e organit organizator të Asamblesë së Përgjithshme të Artistëve.
8. Votimi kryhet i hapur, por sipas rëndësisë së çështjeve, Asambleja, mund të votojë edhe me votim të fshehtë, për çështje, objekti i të cilave, kërkohet të mos bëhet i njohur, vullneti i shprehur i artistëve.

9. Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme, mund të mbledhet, për çështje urgjente, sipas kërkesës së 1/5 së anëtarëve, sipas kërkesës së një anëtari të Këshillit Ekzekutiv, sipas Vendimit të Këshillit Ekzekutiv, sipas kërkesës së Presidentit ose të Presidentit të Nderit :
- (i) për shkak të ndryshimeve ligjore, të cilat duhet të reflektohen në Statut,
 - (ii) për shkak të çështjeve urgjente, që kanë të bëjnë me cenimin e licensës së Agjencisë, të të drejtave të artistëve ose të agjencisë, nga ndonjë vendim administrativ apo gjyqësor,
 - (iii) për shkak të çështjeve urgjente, që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërkombëtare, ku agjencia "AKDIE" është palë,
 - (iv) si dhe për çdo situatë tjetër, që Këshilli Ekzekutiv, e konsideron të domosdoshme vendimmarrjen e Asamblesë së Përgjithshme dhe se nuk pret koha deri në mbledhjen e saj, në kohën e saj të natyrshme.

XVI. NENI 16- KOMPETENCAT E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ANËTARËVE ARTISTË

Organi më i lartë drejtues është Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve Artistë, i cili përveç çështjeve të tjera, që çmon se duhet të shqyrtohen prej tij, ai :

1. Zgjedh anëtarët e Këshillit Ekzekutiv, Këshillit të Ankesave, Këshillin e Auditit dhe Shmangies së konfliktit të interesit.
2. Zgjedh Presidentin e Asamblesë, për një afat 5 vjeçar, më të drejtë rizgjedhjeje, në këtë post.
3. Presidenti i Agjencisë është edhe Presidenti i Këshillit Ekzekutiv.
4. Zgjedh anëtarët e Këshillit Ekzekutiv, sipas zhanreve artistike, sipas grupimeve të artistëve.
5. Vendos për ndryshimin e statutit.
6. Përcakton fushat dhe programet e veprimtarisë.
7. Mbikëqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e tyre.
8. Shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit të agjencisë "AKDIE".
9. Krijon fonde rezerve monetare, për vazhdimësinë e Agjencisë, të administrueshme nga Këshilli Ekzekutiv, Drejtori Ekzekutiv dhe të audituara nga Këshilli i Auditit dhe Shmangies së Konfliktit të Interesit.
10. Miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e organizatës jofitimprurëse dhe shpenzimet për vitin e ardhshëm.
11. Rishikon performancën e përgjithshme dhe miraton shpërblimin e strukturave statutores, si dhe përfitimet e tjera, të tilla si përfitimet monetare dhe jomonetare, dhënie pensionesh apo titujsh, të drejta dhe shpërblime të tjera ose të drejtat për pagesa kalimtare;



12. Vendos për shpërndarjen e shpërblimeve ndaj mbajtësve të të drejtave dhe shpenzimeve të administrimit të të drejtave,
13. Kryen miratimin e çdo blerjeje, shitjeje ose hipoteke të pasurisë së paluajtshme.
14. Nxjerr akte për rregullimin e veprimtarisë, të organizimit dhe të strukturës së organizatës,
15. Krijon komitete të posaçme, si dhe vendos edhe për çështje të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj ose në statut.
16. Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve Artistë, i ushtrojnë funksionet e tyre, në Asamble apo Këshillat e AKDIE, në mënyrë vullnetare dhe pa shpërblim, por me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve Artistë, ata mund të shpërblehen, për raste dhe detyra të vecanta, sipas propozimit të Drejtorit Ekzekutiv.

XVII. NENI 17- KRIJIMI, ADMINISTRIMI DHE EKZEKUTIMI I FONDIT PËR MINISTRINË PËRGJEGJËSE TË TË DREJTËS SË AUTORIT DHE FONDEVE TË TJERA.

1. Tarifat e shpërblimeve të mbledhura nga përdoruesit, të cilat në përfundim të vitit financiar nuk shpërndahen nga AKDIE, depozitohen në një fond special për llogari të ministrisë përgjegjëse për të drejtat e autorit, në dispozicion të artistëve, për një periudhë 3-vjeçare.
2. Gjatë kësaj periudhe, nëse AKDIE, identifikon mbajtësin e së drejtës, siguron shpërndarjen dhe përfiton edhe tarifën e administrimit.
3. Në rast se mbajtësi i të drejtës, nuk identifikohet për një periudhë trevjeçare, fondi special i kalon ministrisë përgjegjëse për të drejtat e autorit, e cila do ta përdorë në përmbushje të objektivave të saj për rritjen e krijimtarisë dhe diversitetin kulturor.
4. Fondet e tjera, të parashikuara në nenin 133 të ligjit nr. 35/2016, krijohen me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve Artistë, sipas propozimit të Drejtorit Ekzekutiv.

XVIII. NENI 18-MËNYRA E MIRATIMIT TË NDRYSHIMIT TË STATUTIT

1. Ndryshimi i Statutit të Agjencisë bëhet nga mbledhja e përgjithshme e anetareve të saj. Ndryshimet në statut bëhen me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të Agjencisë.
2. Çdo propozim për ndryshimin e statutit është objekt i miratimit nga ministri përgjegjës për të drejtat e autorit, sipas propozimit të Drejtorisë për të Drejtën e Autorit.
3. DDA-ja, shqyrton, brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, propozimin për ndryshim të statutit të agjencisë.

4. Miratimi ose refuzimi i propozimit duhet të jetë i argumentuar dhe të shprehet në lidhje me përputhshmërinë e ndryshimeve të statutit me ushtrimin e tagrave të licencës, objekt veprimtarie dhe pastaj miratimi i paraqitet gjykatës së rrethit gjyqësor, me qëllim për regjistrimin e ndryshimit.
5. Çdo ndryshim i statutit, i kryer në kundërshtim me parashikimet e kësaj pike, përbën kusht për heqjen e licencës së agjencisë së administrimit kolektiv.


XIX. NENI 19-PRESIDENTI I AGJENCISË

Presidenti i Agjencise është Z. Jani ÇEKIXHI, i cili ka këto kompetenca:

- 1) Drejton mbledhjen e përgjithshme.
- 2) Presidenti i Agjencisë AKDIE, ka kompetencë të thërras mbledhjen e përgjithshme të anëtarëve, në tre mujorin e parë dhe/apo të fundit, në varësi të veprimtarisë së agjencisë.
- 3) Presidenti i Agjencisë është kryetari që drejton Mbledhjen e përgjithshme.
- 4) Presidenti i Agjencisë është kryetari që drejton Këshillin Ekzekutiv.
- 5) Presidenti është figura përfaqësuese e Agjencisë AKDIE, për nivelet më të larta të përfaqësimit të institucioneve homologe dhe shtetërore, duke vepruar sipas raportit protokollar.
- 6) Presidenti mund të shkarkohet vetëm nga Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme, sipas propozimit të Këshillit Ekzekutiv, me 2/3 e votave të fshehta të anëtarëve të pranishëm në atë mbledhje, kur Presidenti i agjencisë ka kryer :
 - shkelje të kompetencave statutoare të Presidentit të Agjencisë.
 - i është hequr liria, për shkak të një vendimi gjyqësor penal
- 7) Propozimi për shkarkimin e Presidentit në këto raste, mund të bëhet edhe nga jo më pak se një e katërta e anëtarëve të mbledhjes së përgjithshme dhe duhet të mbështetet nga jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij.
- 8) Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme, është përfundimtar.
- 9) Ai mund të jetë objekt ankimi gjyqësor, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas ligjit, brenda një afati 30 ditor.
- 10) Deri në zëvendësimin e tij, nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme, Agjencia AKDIE, drejtohet nga Presidenti i Nderi.

XX. NENI 20-PRESIDENTI I NDERIT

21



- 1) Presidenti i Nderit të Agjencisë "AKDIE" është Z. Robert NDRENIKA.
- 2) Ai ka kompetencë të thërras Asamblenë e Përgjithshme të Anëtarëve Artistë, kur krijohet konflikt midis Drejtorit Ekzekutiv, Presidentit, Këshillit Ekzekutiv apo Këshillit të Auditit.
- 3) Presidenti i nderit të Agjencisë është kryetari që drejton Asamblenë e Përgjithshme të Jashtëzakonshme, për këtë rast.
- 4) Në rast të mungesës së presidenti i agjencisë, ose kur ka konflikt midis Drejtorit Ekzekutiv dhe Presidentit të Këshillit Ekzekutiv, kjo është Mbledhje e Jashtëzakonshme e Këshillit dhe drejtohet nga anëtari më i moshuar i Këshillit Ekzekutiv.
- 5) Presidenti i Nderit mund të largohet nga posti vetëm me kërkesën e tij

XXI. NENI 21-ORGANI DREJTUES EKZEKUTIV- KËSHILLI EKZEKUTIV

1. Agjencia, për nga pikëpamja ekzekutive, drejtohet nje organ ekzekutiv qe quhet Keshilli Ekzekutiv, i cili zgjedh Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë.
2. Këshilli Ekzekutiv i Agjencisë, zgjidhet në çdo 5 vjet, me votim të hapur, nga Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve Artistë, sipas rendit të ditës, të votuar në atë asamble.
3. Anëtarët e Këshillit Ekzekutiv zgjidhen nga Asambleja e Artistëve, sipas zhanreve artistik dhe qëndrojnë në këtë pozitë për jo më pak se 5 vjetë, duke gëzuar të drejtën e qëndrimit edhe për mandatin pasardhës, pakufizim, sipas votëbesimit të Asamblesë së Përgjithshme.
4. Cdo anëtar i Këshillit Ekzekutiv, gëzon të gjitha të drejtat e një anëtari themelues dhe kontribues, duke gëzuar kështu, të drejtën që të largohet nga Këshilli Ekzekutiv, me dëshirën dhe kërkesën e tij.
5. Këshilli Ekzekutiv ka të drejtë të përjashtojë një anëtar të Këshillit Ekzekutiv nga Këshilli dhe ta zëvendësoj atë anëtar, më një tjetër anëtar nga Asambleja e Përgjithshme, por gjithmonë, duke ruajtur, përfaqësimin në Këshill të zhanrit artistik, për shkak të mospjesëmarrjes, për më shumë se 3 (tre) herë në mbledhjen e Këshillit Ekzekutiv.
6. Këshilli Ekzekutiv mund të mblidhet, në selinë e Agjencisë, duke e përcaktuar Presidenti i Këshillit Ekzekutiv, ditën, orën dhe rendin e ditës, sipas kërkesës së Drejtorit Ekzekutiv, por në asnjë rast më pak se 2 (dy) herë në vit, përpara përpilimit të akteve shkresore përfundimtare të Agjencisë, për veprimtarinë financiare të vitit kalendarik dhe të mbylljes së bilancit vjetor për llogari të organit tatimor.
7. Keshilli Ekzekutiv perbehet prej 5 vetëve, të cilët janë:

22

The bottom of the page contains five handwritten signatures in black ink, arranged horizontally. The signatures are stylized and difficult to read, but they appear to be the names of the five members mentioned in the final point of the text above.

- i. Jani Çekixhi
- ii. Ndriçim Xhepa
- iii. Rexhep Çeliku
- iv. Aranit Hoxha
- v. Gramoz Burba.

- Presidenti i Këshillit Ekzekutiv të agjencisë është Z. JANI ÇEKIXHI.

1. Këshilli Ekzekutiv i agjencisë, zgjedh Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë, i cili është organi më i lartë ekzekutiv dhe Sekretariatën e Këshillit Ekzekutiv.


- Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë AKDIE është Z. NAIM ALIAJ
- Sekretariati i Agjencisë zgjidhet, nga Presidenti i Agjencisë, tek administrata teknike e Agjencisë dhe mban proces-verbalin e Mbledhjeve të Këshillit Ekzekutiv dhe të Asamblesë së Përgjithshme.
- Sekretariati shpërblehet, për çdo mbledhje të Këshillit Ekzekutiv ose të Asamblesë së Përgjithshme, sipas akteve financiare të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme të Anëtarëve Artistë.

2. Vendimet e Këshillit Ekzekutiv, merren me shumicën e thjeshtë të votave të pranishme në mbledhje. Në rast se votat janë të barabarta, vota e Presidentit të agjencisë është vendimtare në marrjen e vendimeve.

XXII. NENI 22-KOMPETENCAT E KËSHILLIT EKZEKUTIV

Këshilli Ekzekutiv i agjencisë ka këto kompetenca:

1. Përgatit projekt aktet e veprimtarisë së AKDIE dhe i'a paraqet për miratim Asamblesë së përgjithshme.
2. Miraton raportin vjetor të realizimit të detyrave të agjencisë nga ana e Drejtorit Ekzekutiv.
3. Merr në shqyrtim dhe vendos për propozimet që bëhen nga institucione publike, për administrimin kolektiv të të drejtave, si dhe organizata të ndryshme me qëllim bashkepunimi e ndihme të ndërsjelltë.
4. Diskuton çdo gjë të jashtëzakonshme që vihet në rendin e ditës të mbledhjes dhe merr vendime rreth tij.
5. Vendos për politikën e drejtimit të agjencisë.
6. Këshilli Ekzekutiv propozon për të gjitha fondet sociale, rregullon vendosjen apo zhvendosjen e tyre dhe përdorimin.



7. Këshilli Ekzekutiv shprehet mbi pranimin e artistëve, në cilësi të anëtarëve të agjencisë dhe çdo vit, të paktën dy muaj përpara se të mbledhet Asambleja e Përgjithshme, ai i ndan ata, sipas shkallëve të përcaktuara në grupimet përkatëse të të drejtave.
8. Vendimet që merren nga Këshilli Ekzekutiv, brenda kufijve të atribuave të tij, janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët.
9. Këshilli Ekzekutiv në momentin e zgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv të agjencisë, i ka kaluar atij të gjithë pushtetin ekzekutiv, për të bërë një menaxhim sa më efikas të agjencisë dhe Drejtori është i detyruar të raportojë për administrimin e agjencisë në këtë keshill, në çdo mbledhje të Këshillit Ekzekutiv.


XXIII. NENI 23-KËSHILLI I AUDITIT FINANCIAR DHE SHMANGIES SË KONFLIKTIT TË INTERESIT

1. Agjencia, për nga pikëpamja auditimit, kontrollohet nga Këshilli i Auditimit.
2. Këshilli Auditimit të Agjencisë, zgjidhet në çdo 5 vjet, me votim të hapur, nga Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme, sipas rendit të ditës, të votuar në atë asamble.
3. Anëtarët e Këshillit të Auditimit, zgjidhen nga Asambleja e Artistëve dhe qëndrojnë në këtë pozitë për 5 vjetë, duke gëzuar të drejtën e qëndrimit edhe për mandatin pasardhës, pakufizim, sipas votëbesimit të Asamblesë së Përgjithshme.
4. Cdo anëtar i Këshillit, gëzon të gjitha të drejtat e një anëtari, duke gëzuar kështu të drejtën që të largohet nga Këshilli, me dëshirën dhe kërkesën e tij.
5. Këshilli, ka të drejtë të përjashtojë një anëtar nga Këshilli dhe ta zëvendësojë atë anëtar, me një tjetër anëtar nga Asambleja e Përgjithshme.
6. Këshilli mbledhet, në selinë e Agjencisë, duke e përcaktuar Presidenti i Agjencisë, ditën, orën dhe rendin e ditës, sipas kërkesës së Drejtorit Ekzekutiv, por në asnjë rast, më pak se 2 (dy) herë në vit, përpara përpilimit të akteve shkresore përfundimtare të Agjencisë, për veprimtarinë financiare të vitit kalendarik dhe të mbylljes së bilancit vjetor për llogari të organit tatimor, shpërndarjeve për artistët shqiptar dhe shpërndarjen për artistët e huaj.
7. Këshilli i Auditimit dhe konfliktit të interesi, përbëhet prej 3 vetëve.

XXIV. NENI 24- KOMPETENCAT E KËSHILLIT TË AUDITIT DHE SHMANGIES SË KONFLIKTIT TË INTERESIT

Këshilli i Auditit, ka këto kompetenca:

24



- 1) Kontrollon mënyrën e mbledhjes së parave, futjen në arkë dhe shpërndarjen e tyre tek artistët, sipas normave statutorë dhe ndërkombëtare.
- 2) Kontrollon informacionin e përdorimit të të drejtave, monitorimin e tyre dhe klasifikimin e çdo veprë, duke kontrolluar tabelat e llogaritjeve.
- 3) Kontrollon rrethanat e konfliktit të interesit, në veprimtarinë e AKDIE, sipas ligjit në fuqi për parandalimin dhe shmangien e konfliktit të interesit.
- 4) Kontrollon rrethanat e mundshme të diskriminimit apo mungesës së transparencës në veprimtariën e Agjencisë.
- 5) Kontrollon gjëndjen e burimeve monetare të AKDIE, përfshi arkën për shpenzimet e domosdoshme ditore, llogaritë bankare të AKDIE, administrimin e fondeve.
- 6) Këshilli i Auditimit ka të drejtën e angazhimit të një studio auditimi, të pavarur nga studio kontabël e Administratës së Agjencisë AKDIE.
- 7) Agjencia AKDIE, paguan koston përkatëse të këtij shërbimi, nga Fondet e Asamblesë së Përgjithshme, me qëllim pavarësinë e këtij Këshilli.

XXV. NENI 25- DREJTORI EKZEKUTIV

- 1) Drejtori Ekzekutiv i agjencisë zgjidhet nga Këshilli i Ekzekutivit, me votë të fshehtë.
- 2) Ai quhet i zgjedhur, me votë në mënyrë unanime, nga ana e anëtarëve të Këshillit të Ekzekutivit.
- 3) Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë "AKDIE" është Z. Naim ALIAJ.
- 4) Drejtori Ekzekutiv emëron dhe shkarkon personelin administrativ të Agjencisë.
- 5) Paga e Drejtorit Ekzekutiv përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve Artistë, me vendim të saj.
- 6) Drejtori Ekzekutiv është përfaqësuesi ligjor i Agjencisë AKDIE, në përgjithësi me të tretë, por për nivelet më të larta të përfaqësimit të institucioneve homologe dhe shtetërore, sipas raportit protokollar, zbatohet e drejta e përfaqësimit me të tretët nga Presidenti.
- 7) Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë AKDIE, mund të largohet me dëshirën e tij nga detyra, sipas kërkesës së tij, të paraqitur në Këshillin Ekzekutiv.
- 8) Këshilli Ekzekutiv zëvendëson Drejtorin Ekzekutiv, me një nga nëpunësit e lartë të Agjencisë, menjëherë pas marrjes së kësaj kërkesë.


25

- 9) Konsiderohet dorëheqje e parevokueshme e Drejtorit Ekzekutiv, mos njoftimi i Këshillit Ekzekutiv dhe Këshillit të Auditit, për gjëndjen e paaftësisë paguese të agjencisë, me anë të akteve postare, telefonike apo me postë elektronike.
- 10) Drejtori Ekzekutiv mund të shkarkohet nga Vendimi i Këshilli Ekzekutiv, me votim unanim të të gjithë anëtarëve të tij, duke i garantuar të drejtën e mbrojtjes së Drejtorit të Agjencisë, përpara Asamblesë së Artistëve, për këto shkaqe :
- (i) Për shkelje të kompetencave të tij statutore.
 - (ii) Për kryerjen e një krimi të rëndë penal.
- 11) Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme, në një rast të tillë, drejtohet nga Presidenti i Nderit ose në mungesë të Presidentit të Nderit, nga anëtari më i vjetër i Agjencisë, i cili nuk është anëtar i Këshillit Ekzekutiv, i cili drejton këtë Mbledhje.
- (i) Drejtuesi i kësaj Asambleje të Jashtëzakonshme, verifikon Vendimmarrjen unanime të Këshillit Ekzekutiv dhe vazhdon procedurën vetëm pasi verifikohet kjo vendimmarrje.
 - (ii) Asambleja e Përgjithshme, organizon dy seanca dëgjimore, brënda një afati të arsyeshëm, të miratuar nga kjo asamble, për të mbledhur provat e mjaftueshme.
 - (iii) Në seancën e parë degjimore dëgjon secilin artist, anëtar të Këshillit Ekzekutiv dhe Drejtorin Ekzekutiv, pa praninë e secilit prej tyre
 - (iv) Në seancën e dytë, i degjon artistët dhe Drejtorin Ekzekutiv, së bashku, në një seancë ballafaqese.
 - (v) Në fund të seancës së dytë, Asambleja e Përgjithshme, del me Vendim.
 - (vi) Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme, është përfundimtar.
 - (vii) Ai mund të jetë objekt ankimi gjyqësor, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas ligjit, brënda një afati 30 ditor.
 - (viii) Drejtori i shkarkuar rri në detyrë, deri në zëvendësimin e tij, nga ana e Këshillit Ekzekutiv.

XXVI. NENI 26-KOMPETENCAT E DREJTORIT EKZEKUTIV

- 1) Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë "AKDIE", me zgjedhjen e tij në këtë post, nga Këshilli Ekzekutiv, ka të gjithë pushtetin ekzekutiv, për të zhvilluar një veprimtari në dobi të shoqërisë, duke marrë përsipër përgjegjësinë të sigurojë dhe të ndjekë ekzekutimin e Vendimeve të Këshillit Ekzekutiv dhe, nën drejtimin e kontrollin e këtij të fundit, të sigurojë në mënyrë të përgjithshme administrimin e Agjencisë, të cilën ai e drejton dhe e mbikqyr në të gjitha shërbimet, si edhe ai është përfaqësues ligjor me të tretet, ku agjencia "AKDIE" futet

26



në marrëdhënie kontraktuale, reciprociteti, probleme gjyqësore dhe problematika administrative.

2) Drejtori Ekzekutiv mban përgjegjësi penale, civile dhe administrative.

3) Drejtori Ekzekutiv ushtron këto kompetenca :

(i) Ai përfaqëson ligjërisht Agjencinë "AKDIE" në cdo proces gjyqësor penal, civil, administrativ apo arbitrazhi.

(ii) Ai ndjek vetë ose vendosë përfaqësues ligjor, me anë të Autorizimit të tij, me vulën e Agjencisë "AKDIE", për cdo proces ligjor, administrativ apo gjyqësor penal, civil dhe administrativ, duke gëzuar cdo lloj tagri ligjor të përfaqësimit ligjor, për përfaqësimin e AKDIE, si person juridik, për përfaqësimin e të drejtave, që ushtron AKDIE, për përfaqësimin e të drejtave të artistëve interpretues/ekzekutues, sipas këtij statuti, sipas kontratave individuale Artist-AKDIE, sipas kontratave të përfaqësimit ndërkombëtar, për artistët e huaj, për përfaqësimin e artistëve, sipas licensës së dhënë nga organi kompetent zyrtar, për administrimin kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues/ekzekutues, si dhe të ndjekë ekzekutimin e tyre, të arrijë marrëveshje jashtegjyqësore apo të heqe dore nga proceset ligjore dhe gjyqësore, si dhe cdo tagër përfaqësimi që rrjedh nga ligji 35/2016.

(iii) Ai mban shkrimet, llogaritë financiare dhe korrespondencën e Agjencisë.

(iv) Ai siguron arkëtimet dhe mbledhjen e te drejtave të administrueshme nga Agjencia "AKDIE".

(v) Ai disponon llogarinë bankare dhe arkën e Agjencisë.

(vi) Ai siguron zbatimin e buxhetit dhe të shpenzimeve që rrjedhin nga nevoja e funksionimit të Agjencisë.

(vii) Ai përgatit tabelën e shpërndarjes së të ardhurave:

(a) për çdo vepër artistike të përdorur,

(b) për cdo artist kontribues në këtë vepër,


(c) shpeshësinë e përdorimit të veprës,

(d) koeficientin e shpërblimit të vlerave monetare totale/për minutazh vjetor përdorimi, sipas skemës vlera monetare të mbledhura në total nga përdoruesit Kryesor dhe nga përdoruesit Dytësor,

(e) duke hequr paraprakisht, detyrimet detyrimet tatimore, komisionin statutor ose shpenzimet e domosdoshme të Agjencisë, sipas Buxhetit të miratuar dhe i'a paraqet Keshillit Ekzekutiv për aprovim.

4) Ai është i detyruar të marrë pjesë në të gjitha Mbledhjet e Asambleve të Përgjithshme të Agjencisë dhe në Mbledhjet e Keshillave të AKDIE.

27



- 5) Ai depoziton vlerat monetare, sipas akteve të Asamblesë së Përgjithshme për fondet financiare dhe ka të drejtë të rialokojë fondet, sipas interesit më të mirë të agjencisë, nën kontrollin e Këshillit Ekzekutiv dhe Këshillit të Auditit e Shmangies së Konfliktit të Interesit.

XXVII. NENI 27-BURIMET FINANCIARE

1. Burimet e të adhurave të Agjencisë "AKDIE" janë :
- (i) Kuotizacioni, kur ka te tilla dhe vlera e kuotizacionit të një artisti, për agjencinë AKDIE është 2 500 lekë në vit.
 - (ii) Grante dhe donacionet nga subjekte private dhe publike, vendas ose te huaj.
 - (iii) Tarifat ligjore, e parashikuar ne ligjin për të drejtën e autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të, për administrim kolektiv.
 - (iv) Cdo lloj tjetër të ardhure, të lejuar nga ligji për organizatat jofitimprurëse dhe e rregullat ndërkombëtare.

XXVIII. NENI 28- RREGULLAT PËR BASHKIMIN, NDARJEN E ORGANIZATËS JOFITIMPRURËSE DHE RREGULLAT PËR LIKUIDIMIN E PASURISË PAS MBARIMIT TË ORGANIZATËS.

1. Agjencia "AKDIE" ka te drejte te transformohet ose te bashkohet me vendim te organit kompetent, sipas aktit të Asamblesë së Përgjithshme dhe konsiderohet e shperndare me regjistrimin e subjektit te ri.
2. Agjencia e Administrimit Kolektiv te te Drejtes se Artisteve Interpretues dhe /ose Ekzekutues "AKDIE", si organizatë jo fitimprurëse, shpërndahe me iniciativen e saj, duke kryer likuidimin e saj, sipas ligjit në fuqi ose me vendim gjykate, sipas legjislacionit në fuqi, në rastet kur :
- i. Veprimtaria e Agjencisë vjen në kundërshtim me Kushtetutën.
 - ii. Kur Agjencia kryen veprimtari të kundraligjshme.
 - iii. Kur Agjencia ka falimentuar sipas ligjit "Per falimentimin".

XXIX. NENI 29- PAAFTËSIA PAGUESE E AGJENCISË DHE MËNYRA E PËRDORIMIT TË KAPITALIT OSE ASETIVE TË TJERA, NË RAST LIKUIDIMI TË AKDIE

1. Në rast se Agjencia AKDIE, nuk ka aftësi paguese për zhvillimin e veprimtarisë së saj, Drejtori Ekzekutiv njofton Drejtorinë e të Drejtës së Autorit dhe Ministrin përgjegjës për të drejtën e autorit, për faktin e paaftësisë paguese.

2. Në rastin kur vlera e kostos mujore të punës së administrimit kolektiv, nuk mjafton për të përballuar shpenzimet e domosdoshme, si vijon:


1. Zëri i pagave të administratës qëndore dhe vendore
2. Zëri i qerasë
3. Zëri i energjisë elektrike, ujit, telefonisë, internetit
4. Zëri i kancelarisë-letër bojë printeri, rregullim kompiuterash, postës,
5. Zëri i shpenzimeve të domosdoshme ligjore gjyqësore,
6. Zëri i shpenzimeve të domosdoshme të udhëtimit, dietave, naftës, qerasë së makinave, etj.
7. Zëri i komisioneve bankare
8. Zëri i shpenzimeve të panjohura

Drejtori Ekzekutiv, është i detyruar të jap dorëheqje ose ai konsiderohet i shkarkuar nga detyra automatikisht, sikur të kishte dhënë dorëheqje të parevokueshme, duke u zëvendësuar menjëherë, nga një nëpunës i lartë i administratës së agjencisë, i caktuar me vendim të Këshillit Ekzekutiv.

3. Drejtori i ri Ekzekutiv, ka detyrimin e rregullimit të gjëndjes financiare menjëherë dhe mos rregullimi i situatës edhe nga Drejtori i ri Ekzekutiv, con në dorëheqje të parevokueshme të Këshillit Ekzekutiv dhe Këshillit të Auditit e Shmangies së Konfliktit të Interesit.
4. Presidenti i Nderit, mbledh Asamblenë e Jashtëzakonshme të Artistëve, me qëllim zgjedhjen e Këshillit të ri Ekzekutiv, i cili, konstaton dorëheqjen e parevokueshme edhe të drejtorit të dytë, i cili ishte i paaftë për të zgjidhur situatën, zgjedh një drejtor të ri ekzekutiv, si dhe të Këshillit të ri të Auditit e Shmangies së Konfliktit të interesit, duke ruajtur të pacënuar vijimësinë e agjencisë.
5. Në rast se edhe kjo trup drejtuese, nuk e zgjidh situatën, Drejtori Ekzekutiv i fundit, plotëson procedurat për falimentimin e agjencisë, sipas ligjit "Për falimentimin në Republikën e Shqipërisë".
6. Cdo anëtar i agjencisë AKDIE, do të konsiderohet përfitues i aseteve të saj, pas procedurave të falimentimit ose likuidimit, sipas legjislacionit në fuqi.

XXX. NENI 30- KAPITALI FILLESTAR DHE BURIMET E PLANIFIKUARA EKONOMIKE.

1. Kapitali fillestar i AKDIE, rrjedh nga anëtarësia e saj fillestare.



29

2. Pagesa e kontributit të anëtarësisë është në vlerën 2 500 lekë dhe kjo vlerë i mbahet anëtarit, nga vlera monetare, që agjencia AKDIE, ka detyrimin t'i jap, për shkak të përdorimit të të drejtave, në një vit kalendarik.
3. AKDIE, ka të drejtën e nënshkrimit të kontratave me artistë ose grupim artistësh, mjafton që të përfaqësojnë të drejtat e artistëve në veprën artistike, objekt kontrate, sipas neni 132 të ligjit nr. 35/2016, duke përfutuar koston e administrimit, pasi të heq detyrimet tatimore dhe detyrimet e tjera, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Agjencia AKDIE, zotëron mundësitë ekonomike, si një institucion i të drejtës private, aktiv prej vitit 2008, duke përfshirë asetet e luajtshme afatgjata dhe afatmesme, sipas pasqyrave të saj financiare tatimore.
5. Burimet finaciare të Agjencisë AKDIE, vijnë vetëm nga veprimtaria e saj e ligjshme, në përputhje me ligjin për të drejtën e autorit dhe ligjin për organizatat jofitimprurëse në Shqipëri.
6. Agjencia AKDIE, konsideron si burime të planifikuara ekonomike, të gjitha kontratat me përdoruesit e të drejtave të artistëve, sipas ligjit.

XXXI. NENI 31-ADMINISTRATA E AGJENCISË

1. Të ardhurat e buxhetimit, nuk duhet të jetë më e vogël sesa detyrimi ligjor i pagave të domosdoshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së agjencisë, të paktën me stafin e përcaktuar në aktet nënligjore të Ministrisë së Kulturës.
2. Agjencia "AKDIE" ka një administratë, e cila drejtohet nga Drejtori Ekzekutiv.
3. Administrata e AKDIE, rekrutohet nga ana e Drejtorit Ekzekutiv, pas deklarimit se nuk ka asnjë lloj konflikti interesi me agjencinë.
4. Çdo nëpunës i Agjencisë „AKDIE“, i nënshtrohet statutit, ligjit për organizatat jofitimprurëse, Kodit të Punës, Kontratave të Porosisë dhe të gjitha kërkesave të ligjit për shmangien e konfliktit të interesit.
5. Drejtori Ekzekutiv, drejton Administratën e AKDIE, sipas Urdhërave, Udhëzimeve dhe normave të etikës.
6. Administrata e Agjencisë „AKDIE“, përbëhet nga Zyra Juridike, Zyra Për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Publikun, Zyra e teknologjisë së Informacionit dhe Rregjistrimit të Repertorit të Artistëve, Zyra e Monitorimit në Terren, Zyra e Financës.
7. Nëpunësit e administratës janë Përgjegjës zyre dhe specialist.

8. Paga për përgjegjës zyre janë jo më pak se 60 000 lekë, pa taksa, NETO.
9. Paga për specialistë janë jo më pak se 40 000 lekë, pa taksa, NETO.
10. Drejtori Ekzekutiv, ka të drejtën e kontraktimit të cdo shërbimi të administratës së Agjencisë, tek subjekte të tjera tatimpagues, sipas kontratave të shërbimit apo porosisë, me qëllim rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së agjencisë, mjafton që zëri i shpenzimeve të domosdoshme, të mos kalojë vlerat e përcaktuara në ligjin nr. 35/2016.

XXXII. NENI 32-RREGULLAT PËR MODALITETET E HARTIMIT TË METODOLOGJISË QË DUHET TË NEGOCIOHET ME PËRDORUESIT

Agjencia AKDIE, me qëllim mbledhjen e të ardhurave, nga përdorimi i të drejtave të anëtarëve të saj, në modalitetet e hartimit të metodologjisë që duhet të negociohet me përdoruesit, udhëhiqet nga legjislacioni për të drejtën e autorit dhe legjislacioni tatimor, sipas rregullave në lidhje me shpërndarjen e shpërblimeve, të këtij statuti.

XXXIII. NENI 33- E DREJTA E INFORMIMIT

1. Cdo artist, ka të drejtë të marrë informacion për administrimin financiar dhe ekonomik të agjencisë sipas ligjit në fuqi, sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj dhe në ligjin për të drejtën e informimit dhe këtij Statuti.
2. Veprimtaria financiare e AKDIE behet publike nepermjet faqes se saj ne internet.


XXXIV. NENI 34-PREZANTIMI I AGJENCISË, RREGULLAT E PËRFAQËSIMIT NË NEGOCIATA

Agjencia e Administrimit Kolektiv përfaqësohet ligjërisht nga Drejtori Ekzekutiv, përjashtuar rastet protokollare, ku përfaqësimi kryhet nga Presidenti ose Presidenti I Nderit.

Drejtori ekzekutiv ka të drejtën e kalimit të përfaqësimit në negociata të agjencisë, sipas ligjit, zyrës së avokatisë apo cdo subjekti të specializuar, në fushën e të drejtës së autorit, në interesin më të mirë të agjencisë.

XXXV. NENI 35-E DREJTA PER ADMINISTRIMIN KOLEKTIV RECIPROK ME SHOQËRITË SIMOTRA NDËRKOMBËTARE DHE RREGULLA BAZIKE PËR ADMINISTRIM KOLEKTIV RECIPROK

1. Agjencia e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Artistëve interpretues/ekzekutues "AKDIE" ka detyrimin e nënshkrimit të Kontratave të Përfaqësimit Reciprok, me agjencitë- Shoqëritë e



Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Artistëve, duke marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet reciproke, sipas normave juridike ndërkombëtare, me qëllim ushtrimin dhe përfaqësimin e të drejtave të administrimit kolektiv, sipas të drejtave dhe territoreve përkatëse të veprimtarisë së secilës.

2. Në përputhje me Konventat dhe traktatet ndërkombëtare, "AKDIE" garanton të njëjtin trajtim ligjor, si për repertorin e huaj ashtu dhe atë vendas, si për artistin e huaj, ashtu edhe për artistin shqiptar.
3. Shpërndarja e shpërblimeve të mbledhura, pasi hiqen kostot ligjore tatimore dhe ato të komisionit të agjencisë për shpenzimet e domosdoshme, për arritjen e qëllimit të krijimit të saj, kryhet vetëm në bazë të shpeshtësisë së përdorimit të veprës, sipas minutazhit të veprës, e shumëzuar me koeficientin që del nga pagesë e arkëtuar me minutat e vitit kalendarik.
4. Pagesat për artistët shqiptarë, kryhet nëpërmjet RAIFFEISEN BANK, në numrat e llogarisë bankare, të cdo artisti.
5. Pagesat për artistët e huaj, kryhen nëpërmjet RAIFFEISEN BANK, sipas saktësisë së Kontrollit Financiar të organizatave Ndërkombëtare AEPO-ARTIS dhe SCAPR, duke dërguar pagesat tek artistët, nëpërmjet Agjencisë së Administrimit Kolektiv, të territorit përkatës.
6. Për cdo veprim të mësipërm, Agjencia "AKDIE" informon organin e administratës publike, kompetent, për zbatimin e ligjit për të drejtën e autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të.
7. Agjencia "AKDIE" udhëhiqet nga parimi i etikës, ku respektohen me përpikmëri vendimet detyruese të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve Artistë, Këshillave përkatës dhe të Drejtorit Ekzekutiv, të cilët nuk mund dhe nuk duhet të kenë konflikt interesi me qëllimet e agjencisë, duke u shmangur interesi i drejtëpërdrejtë apo i tërthortë, sipas ligjit të vecantë në fuqi, për konfliktin e interesit.

ASAMBLEJA E ARTISTËVE

ANËTARËT E AGJENCISË AKDIE

Robert Ndrenika

Tefta Radi,

Arben Duro,

Vasillaq Vangjeli

Liljana Kondakci,

Meri Kareco,

Rexhep Çeliku,

Anita Tartari,

Ndriçim Xhepa

Ardian Trebicka

Jani Çekishi

Denis Skura,

Fatos Bardulla,



Sokol Idërshaj



Agron Bulku,

Afrim Kica



Julian Gjojdeshi

Aranit Hoxha

Klodian Kaçani

Arben Bilali



Zaim Hasrama




Zhani PETROPULLOS (ZICISHTI)

Mark TOPALLAJ,

Gjergj TOPALLAJ



Domenika NDRECA,




Lorena ISAKU,



VERTETIM

Sot, me date 03.10.2017 para meje noteres Gentiana Brati, anetare e Dhomes se Noterise Tirane, u paraqiten personalisht:

1. Robert Ndrejka, i dtl.10.01.1942, lindur e banues ne Tirane, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar sipas kartes se indentitetit E20110150I
 2. Liljana Kondacki, e dtl.12.10.1952, lindur e banuese ne Tirane, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, e identifikuar sipas kartes se indentitetit F26012029E
 3. Ndrim Xhepa, i dtl.21.01.1957, lindur e banues ne Tirane, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar sipas kartes se indentitetit FR70121068V
 4. Fatos Bardulla, i dtl.21.03.1974, lindur ne Diber e banues ne Tirane, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar sipas kartes se indentitetit H40321062W
 5. Zaim Hasrama, i dtl.16.01.1974, lindur ne Vore Tirane e banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar sipas kartes se indentitetit nr.024417660,
 6. Sokol Hidersha, i dtl.15.05.1969, lindur ne Elbasan, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar sipas kartes se indentitetit G90515082Q
 7. Aranit Hoxha, i dtl.31.10.1985, lindur ne Tropoje, dtl.10.01.1942, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar sipas kartes se indentitetit I51031031P
 8. Domenika Ndreca, e dtl.21.02.1956, lindur e banuese ne Tirane, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, e identifikuar sipas kartes se indentitetit F65221066P
 9. Rexhep Celiku, i dtl. 19.07.19054, lindur e banues ne Tirane, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar sipas kartes se indentitetit F40719071V.
 10. Jani Cekixhi, i dtl.14.02.1962, lindur dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar sipas kartes se indentitetit nr.G20214144H,
 11. Agron Bulku, dtl.20.03.1964, lindur e banues ne Tirane, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar sipas kartes se indentitetit G40320131Q
 12. Lorena Isaku, e dtl.10.03.1985, lindur e banues ne Tirane, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, e identifikuar sipas kartes se indentitetit I55330102Q
 13. Luiza Vangjeli, e dtl.19.10.1958, lindur ne Elbasan dhe banuese ne Tirane, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, e identifikuar sipas kartes se indentitetit me nr.F86019057E.
 14. Denis Skura, i dtl.28.05.1987, lindur ne Lac Kruje, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar sipas kartes se indentitetit I76528069D
- te cilet deklaruan se sa me sipër statuti i AKDIE, u nenshkrua para meje noteres me vullnetin e tyre te lire e te plote. Ne keto kushte une noterja vertetoj rregullesine e nenshkrimet sipas ligjit.



[Handwritten signature]